

Mundësi për përfshirje të Bashkive në programin “Twinning Learning Programme” të NetZeroCities

Synimi i thirrjes:

Thirrja ka për qëllim përzgjedhjen e **19 Bashkive “Twin Cities”** që do të bashkëpunojnë me 19 Bashki të përzgjedhura më parë si “Mission Cities” në kuadër të misionit të BE-së për “Qytete klimatike neutrale dhe të zgjuara deri në vitin 2030”. Përmes këtij bashkëpunimi synohet rritja e kapaciteteve për veprim klimatik, shkëmbimi i njohurive dhe krijimi i planeve konkrete për replikimin e veprimeve klimatike.

Fushat e veprimit të thirrjes:

Fokusi është në replikimin e veprimeve klimatike konkrete në këto fusha:

- Neutraliteti klimatik
- Planifikimi urban i qëndrueshëm
- Përdorimi i energjisë dhe burimeve të rinovueshme
- Menaxhimi i emetimeve nga ndërtesat, transporti, industria dhe mbetjet
- Aktivizimi i ekosistemit vendor për veprim klimatik

Rezultatet e pritshme:

- Hartimi i një Plani të Replikimit të Veprimit Klimatik për secilën bashki “Twin City”;
- Ndërtimi i një partneriteti të qëndrueshëm midis bashkive;
- Përmirësimi i kapaciteteve lokale për planifikim dhe zbatim të veprimeve klimatike;
- Realizimi i dy vizitave në terren (vizitë dhe pritje) dhe pjesëmarrja në sesione mësimore të strukturuar.

Kush mund të aplikojë:

- Vetëm autoritetet vendore nga vendet anëtare të BE-së ose vende të asociuara me Horizon Europe (përfshirë Shqipërinë);
- Bashkia duhet të ketë një angazhim të formalizuar për neutralitet klimatik para ose deri në 2050;
- Të caktojë dy përfaqësues me njohuri të anglishtes B2+ dhe të ketë kapacitet të angazhojë të paktën 8 orë/muaj përgjatë periudhës 12-mujore.

Aktivitetet:

- Pjesëmarrje në **tre module mësimore** (online dhe në terren)
- Organizimi i **dy vizitave** ndër-bashkiake (një në bashkinë e përfshirë në Misionin e NetZeroCities dhe një në bashkinë binjake)
- Zhvillimi i një “Twinning Learning Roadmap” dhe një “Replication Plan”;
- Pjesëmarrje në workshop dhe seksione të ndërveprimit me bashkinë binjake dhe facilituesin e caktuar.

Cili është buxheti i thirrjes për secilën bashki:

- Rimbursim deri në **900 EUR** për përfaqësues për çdo vizitë jashtë bashkisë së tyre (maksimumi 2 përfaqësues për vizitë);
- Rimbursim deri në **700 EUR** për shpenzime për pritjen e vizitës dy-ditore të bashkisë së Misionit në bashkinë Twin City (logjistikë, transport lokal, ushqim, jo për udhëtim që do të mbulohet veçmas për bashkinë e Misionit).

Si bëhet aplikimi:

Bashkitë “Twin Cities” të interesuara për t'u bashkuar me Programin e Mësimit të Binjakëzimit mund të dorëzojnë aplikimin përmes një formulari online në adresën: <https://ec.europa.eu/eusurvey/runner/NZCTwinning>

Për çdo pyetje, mund të kontaktoni twinning@netzerocities.eu

Kur do të zhvillohen Seksionet e informimit:

- 3 korrik 2025
- 6 gusht 2025
- 26 gusht 2025
- 2 shtator 2025

Të gjitha mbahen online dhe kërkohet regjistrim për pjesëmarrje.

Kur është afati i fundit:

Afati i fundit për aplikim është **12 shtator 2025, ora 17:00 CET.**

Linku i thirrjes:

<https://netzerocities.eu/twin-cities-mission-cities-2025>